RREGULLORE PËR PROKURIM PUBLIK

Rregullat aktuale për procedurat e prokurimit janë nxjerrë në pajtim me Nenin 87.2.5 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës (këtu e tutje LPP).

Rregullat plotësojnë dhe japin sqarime mbi dispozitat e LPP-së dhe do të interpretohet në pajtueshmëri me dispozitat e LPP-së.

Neni 1
Fushëveprimi i zbatimit dhe përdorimi i formularëve standard

1. Brenda fushëveprimit të LPP-së siç është specifikuar në Nenin 2 të LPP-së, rregullat aktuale do të zbatohen nga autoritetet kontraktuese, personat, operatorë ekonomik dhe ndërmarrjet ashtu siç janë përkufizuar këta persona juridik dhe fizik në Nenin 4, paragrafi 1, të LPP-së.

2. Në zbatim të Nenit 87 të LPP-së, autoritetet kontraktuese duhet të përgatisin dokumentet e tyre të prokurimit duke përdorur formularët relevantë standard që mund të gjenden në faqen e internetit të KRPP-së: **www.krpp.rks-gov.net.**

"Përdorimi i formularëve standard" këtu do të thotë që dokumentet e prokurimit do të përmbajnë të paktën tërë informatat, kërkesat, specifikacionet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informata të obligueshme, dhe në përgjithësi të jenë të qarta dhe të kuptueshme për operatorët ekonomik të interesuar.

Neni 2
Kalkulimi i vlerës së parashikuar të kontratës publike

1. Në zbatim të Neneve 16 deri në 18 të LPP-së, vlera e kontratës publike të paraparë duhet të llogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Llogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për sa i përket shfrytëzimit sa më efikas, leverdisë ekonomike, transparencës dhe shfrytëzimit të drejtë të fondeve dhe të burimeve publike.

2. Gjatë llogaritjes së vlerës së kontratës, autoriteti kontraktues duhet të konsideroj:

2.1 çmimet e publikuara, nga Zyra e Statistikave të Kosovës dhe/ose nga ndonjë tjetër tregues zyrtar çmimesh (siç është zyra e taksave, zyra e doganave, oda ekonomike, etj); dhe/ose

2.2 çmimet e tregut lokal; dhe/ose

2.3 çmimet e kontratave të mëparshme të nënshkruara nga autoriteti i njëjtë apo tjetër kontraktues; dhe/ose

2.4 çmime ndërkombëtare të publikuara.

3. Autoriteti kontraktues përgjegjës duhet të inicioi krahasimin e çmimeve në dispozicion së bashku me analizën e kostos së specifikave relevante teknike në lidhje me mallrat, shërbimet ose punët që duhet prokuruar.

4. Në raste të kontratave të përbëra nga një sërë punësh, mallrash ose shërbimesh homogjene që i shërbejnë një qëllimi të njëjtë dhe ku vlerat e kombinuara janë të atilla ku vetëm një numër i vogël i operatorëve ekonomik do të ishin në gjendje t'i siguronin ato, kontrata mund të ndahet në pjesë (lote). Ndarja në lote mund të bëhet në mënyrë që të inkurajohet pjesëmarrje e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe/ose për të kursyer resurse përmes reduktimit të numrit të tenderëve. Ndarja në lote nuk do të afektoj vlerën e tenderit pasi që përbëhet nga vlerat e përbashkët e loteve.

5. Në raste ku kontratat publike të cilat janë të natyrës së zakonshme ose parashikohen të përsëriten brenda një periudhe të caktuar, kalkulimi i vlerës së parashikuar të kontratës do të bazohet në nevojat e parashikuara të lëndës së kontratave të tillë për vitin fiskal ose për një periudhë përkatëse dymbëdhjetë muajsh.

6. Kur një kontratë e parashikuar përmban një opsion, vlera e kontratës duhet të jetë e potencialit maksimal të shumës totale të kontratës duke përfshirë opsionin e tillë. Opsion do të thotë e drejta e autoritetit kontraktues të kërkoj dorëzime shtesë me çmim të njëjtë dhe sipas kushteve të njëjta të përcaktuara në kontratë. Opsione të tilla duhet të përfshihen në publikime dhe të specifikohen në dosjen e tenderit. Përndryshe opsionet nuk mund të kërkohen.

7. Në raste kur ka ndryshime sipas një vendimi të një organi kompetent, në tatime, normën e TVSH-së apo ndryshime në tarifat për import, çmimet e kontratës duhet të rregullohen në përputhje me rrethanat.

8. Autoritetet Kontraktuese nuk lejohen të bëjnë ndërprerjen e kontratave në proces si dhe kontratave për punë, shërbime apo furnizimeve dhe pagesave, kur ndryshimet nuk kanë qenë të njohura, si në rastet e cekura nën paragrafin 7 të këtij Neni.

Neni 3
Klasifikimi i kontratës publike ose konkursit të projektimit sipas vlerës së parashikuar

1. Në zbatim të Nenit 19 të LPP-së, kodet në vijim duhet të shfrytëzohen për klasën e kontratës publike të paraparë sipas vlerës së parashikuar, në "Numrin e Prokurimit" siç përcaktohet në nenin 4 të këtyre rregullave:

1. Kontratë me vlerë të madhe,
2. Kontratë me vlerë të mesme,
3. Kontratë me vlerë të ultë,
4. Kontratë me vlerë minimale.

2. Gjatë klasifikimit të konkursit të projektimit sipas vlerës së parashikuar ose të llogaritur në bazë të nenit 20 të LPP-së, kodet e përmendura në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave do të shfrytëzohen në mënyrë analoge me "Numrin e Prokurimit", përveç kodit "4" që nuk është i zbatueshëm për konkurset e projektimit.

Neni 4
Numri i prokurimit

1. Çdo aktivitet i prokurimit do të shënohet me kod nga autoriteti kontraktues me "Numër të Prokurimit" për identifikim të shpejtë dhe për aktivitete të monitorimit, për qëllime statistikore, etj.

1.1 Numri i prokurimit, i krijuar përmes kësaj, përbëhet nga elementet në vijim:

I. Identifikimi i Autoritetit Kontraktues;
II. Identifikimi i vitit të prokurimit;
III. Numrit serial prej 3 shifrave, duke rifilluar me 1 secilin vit të prokurimit;
IV. Kodi për llojin e prokurimit, siç është referuar në Paragrafin 2 të këtij Neni;
V. Kodi për parametrat e vlerës së parashikuar të kontratës së planifikuar ose konkursit të projektimit, siç është referuar në Nenin 3, Paragrafin 1 dhe 2 të këtyre rregullave;
VI. Kodi i procedurës që është përdorur,siç është referuar në Paragrafin 3 të këtij Neni.

2. Duke ju referuar paragrafit 1.1, pjesa (iv), e këtij Neni, kodet për llojin e prokurimit për përdorim në Numër të prokurimit, janë si në vijim:

1. për Furnizime,
2. për Shërbime,
3. për Shërbime të konsulencës,
4. për Konkurs të projektimit,
5. për Punë,
6. për Koncesion të punëve.

3. Duke ju referuar paragrafit 1.1, pjesës (vi), të këtij Neni, kodet për procedurën e prokurimit që do të përdorët në Numrin e prokurimit, janë si në vijim:

1. për Procedurë të hapur,
2. për Procedurë të kufizuar,
3. për Konkurs të projektimit,
4. për Procedurë të Negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë,
5. për Procedurë të Negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë,
6. për Procedurë të kuotimit të çmimeve,
7. për Procedurë të kontratave me vlerë minimale.

Neni 5
Raporti përmbledhës

Autoriteti kontraktues do të hartojë një raport përmbledhës të konsoliduar vjetor për secilën kontratë publike që është nënshkruar në vitin fiskal paraprak. Një raport i tillë duhet të përgatitet duke përdorur formularin standard dhe t'i dërgohet KRPP-së brenda 5 ditëve pas kërkesës me shkrim, por jo më vonë se me 31 janar të çdo viti fiskal.

Neni 6
Dosja e Tenderit

1. Në zbatim të Nenit 27 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të hartoj dosjen e tenderit për secilën kontratë të paraparë, përveç nëse kontrata është me vlerë minimale. Kur përdoret konkursi i projektimit duhet të hartohet dosja e konkursit të projektimit. Dosjet e tenderit dhe dosjet e konkursit të projektimit duhet të përgatiten duke përdorur formularët standard relevant.

2. Në rast që specifikacionet teknike dhe/ose informacionet tjera komerciale të përfshira në dosjen e tenderit ose në anekset e saj shprehen në mënyrën me efikase duke përdorur vetëm gjuhën Angleze ose cilëndo gjuhë tjetër të zakonshme komerciale, autoritetet kontraktuese nuk kanë nevojë të përgatitin specifikime të tilla dhe/ose informacione në gjuhën Shqipe dhe Serbe me kusht që nuk krijohet ndonjë diskriminim.

3. Autoriteti kontraktues gjithnjë do të bëjë kopje të dosjes së tenderit, e cila do të dorëzohet te operatorët ekonomik në pajtim me Nenin 48 të LPP. Vetëm në raste të jashtëzakonshme kur materiali përfshin modele të shtrenjta ose sasi të madhe të

printimeve teknike autoriteti kontraktues mund të kërkoj pagesë për dosjen e tenderit.

Neni 7
Specifikacionet Teknike

1. Në zbatim të Nenit 28 dhe 29 të LPP, autoriteti kontraktues do të parashtroj në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të gjitha specifikacionet teknike të cilat çdo tender duhet ti respektoj. Specifikacionet teknike të tilla do të përshkruajnë dhe definojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të lëndës së kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e projektimit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimit, shënjimi dhe etiketimi. Autoriteti kontraktues duhet të tregoj nëse specifikacionet teknike të parashtruara janë të detyrueshme apo kërkesa minimale.

2. Përdorimi i standardeve mund të përfshijë standarde të sigurimit të cilësisë siç është cekur në Nenin 70 të LPP-së.

Neni 8
Kriteret e përzgjedhjes

1. Sipas Nenit 56 të LPP, një operator ekonomik do të konsiderohet si i kualifikuar për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit nëse:

1.1 operatori ekonomik në fjalë dëshmon se është i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhje me nenin 9 të këtyre rregullave, dhe

1.2 operatori ekonomik në fjalë, në rast se autoriteti kontraktues ka vendosur kërkesat minimale të kualifikimit, plotëson kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.

2. Kriteret e përshtatmërisë dhe kërkesat minimale për kualifikimit së bashku karakterizohen si "kritere të përzgjedhjes". Kriteret e përzgjedhjes duhet të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

3. Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, autoriteti kontraktues duhet ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të operatorëve ekonomik të rinjë dhe të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë të tillë që nuk përjashton operatorët ekonomik të rinj të cilët posedojnë në një shkallë të kënaqshme mundësitë ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Një shkallë e kënaqshme" duhet të kuptohet si e lidhur me (i) vlerën e parashikuar të kontratës, dhe (ii) shfrytëzimin e drejtë të fondeve publike.

4. Sigurimi i tenderit dhe/ose ekzekutimit mund të përdorën veçanërisht si instrumente për të siguruar ekzekutimin e duhur të kontratës.

Neni 9
Dëshmitë e dokumentuara të përshtatshmërisë

1. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë si dëshmi të mjaftueshme që asnjëri prej rasteve të specifikuara në nenin 65 të LPP-së nuk aplikohet për operatorët ekonomik që marrin pjesë në aktivitetin e prokurimit ose në ekzekutimin e cilësdo kontratë publike, si më poshtë:

1.1 në lidhje me Nenin 65, paragrafët 1.1 dhe 1.2 të LPP-së, deklaratë nën betim e nënshkruar nga operatori ekonomik në fjalë;

1.2 në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit e themelimit të operatorit ekonomik;

1.3 në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8, për sigurimet sociale, dhe 4.9 dhe 4.11 të LPP-së, një certifikatë e lëshuar nga autoriteti kompetent ose operatori publik që dëshmon se një situatë e tillë nuk ekziston.

1.4 në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 të LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik.

1.5 Për sa i përket nenit 65, paragrafi 4.10 të LPP-së, një certifikatë të lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. OSHP-ja është e detyruar të përpilojë një listë për të gjithë operatorët ekonomikë të cilët nuk janë pajtuar me vendimin e lëshuar nga OSHP-ja dhe është i detyruar të publikojë në faqe të internetit.

Provat në lidhje me kërkesat e nenit 65 të LPP-së, do të kërkohen të dorëzohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues synon t'ia japë kontratën. Në rast të procedurës së kufizuar ose të negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë, provat në lidhje me kërkesat për përshtatshmëri do të kërkohen të paraqiten nga aplikantët të cilët autoriteti kontraktues synon që të ftojë për tenderë (lista e shkurtër). Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi ose kandidati paradhënies së kontratës ose para vendimit përfundimtar të Autoritetit Kontraktues për parakualifikim. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës ose parakualifikimit të kandidatit. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe autoriteti kontraktues do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë.

1.6 Në lidhje me të gjitha dispozitat e tjera të përcaktuara në nenin 65 të LPP, si dhe në rastin kur çështja e dokumenteve apo certifikatave të përmendura më lart nuk janë të arritshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat prova duhet të jetë prodhuar, një deklaratë me shkrim të nënshkruar nën betim nga ana e operatorit përkatës ekonomik mund të pranohen si prova të mjaftueshme.

2. Pavarësisht nga neni 65 i LPP –së, në të gjitha rastet, operatorit ekonomik të paraqitur do t'i kërkohet që të pranojë mundësinë e vendosjes së sanksioneve penale dhe civile, të dënimeve dhe gjobave, nëse ai operator ekonomik, me dashje ose nga pakujdesia, ka paraqitur çfarëdo dokumenti, deklarate ose formulari që përmban informata të rreme apo keq-informuese.

Neni 10
Dëshmitë e dokumentuara të përshtatshmërisë profesionale

Në rast kur, operatorët ekonomik janë të obliguar nga autoriteti kontraktues për të paraqitur dëshmi dokumentuese të përshtatshmërisë profesionale të përmendura në nenin 66 të LPP, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një kopje të certifikatës, konfirmuar nga organi administrativ kompetent përgjegjës për vërtetimin e përshtatshmërisë profesionale ose licencave. Dispozitat e nenit 9, paragrafi 2, të rregullave zbatohen gjithashtu për informacionin e dhënë sipas kësaj dispozite.

Neni 11
Dëshmitë e dokumentuara për aftësinë teknike

1. Nëse për ndonjë arsye valide, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues në pajtim me nenet 69 të LPP-së, operatori ekonomik në fjalë mund të lejohet që të tregojnë aftësitë teknike dhe / ose profesionale përmes ndonjë dokumenti tjetër që autoriteti kontraktues, duke siguruar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomik të sapo-krijuar, i konsideron të përshtatshme. Në mënyrë alternative autoriteti kontraktues mund të kërkojë listat e referencave të projekteve dhe detajet nga personi kontaktues dhe t`i verifikojë referencat nëse e gjykon të arsyeshme

2. Sipas kërkesës se një operatori ekonomik për t'iu lejuar për të përdorur dokumentacionin alternativ siç është përmendur në këtë seksion, autoriteti kontraktues duhet ti jap kohën e mjaftueshme operatorit ekonomik për dokumentacionin e përmendur. Afati kohorë i tillë nuk mund të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Neni 12
Grupet e operatorëve ekonomik

1. Sipas Nenit 71 të LPP, një tender mund të dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik.

2. Grupit nuk do t`u kërkohet të marrin një formë të veçantë ligjore për të dorëzuar tenderin; megjithatë, nga grupi i përzgjedhur mund të kërkohet të bëjë kështu pasi që i është dhënë kontrata përkatëse, deri në atë nivel sa kërkesa e tillë është e nevojshme për një ekzekutim të kënaqshëm të kontratës. Në rast të tillë, marrja e një forme të veçantë ligjore duhet të jetë parakusht për nënshkrimin e kontratës

3. Çdo operator ekonomik i këtij grupi duhet t`i plotësojë kërkesat ligjore që dalin nga Neni 65 i LPP-së. Kërkesat që dalin nga neni 68 dhe 69 duhet të plotësohen nga grupi në tërësi.

4. Operatorët Ekonomikë nuk lejohen të paraqesin një tender si individ dhe si pjesëtar i një "grupi" tjetër në të njëjtën kohë në aktivitetin e prokurimit të njëjtë.

5. Ky grup nuk do të ndryshohet pas dorëzimit të tenderit, nëse ndodhë kështu tenderi duhet të refuzohet.

Neni 13
Instrumentet e pranueshme për sigurimin e tenderit dhe të ekzekutimit

1. Nëse aktiviteti i prokurimit është i ndarë në pjesë (Lot) dhe nëse kërkohet depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se tre përqind (3%) dhe jo më shumë se pesë përqind (5%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit apo pjesës (Lot-it), për të cilat operatori ekonomik oferton, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se njëmijë (1.000) Euro**.**

2. Pavarësisht nga nenet 57 dhe 63 të LPP-së, sigurimi i tenderit dhe i ekzekutimit duhet të jenë të pakushtëzuar. Për qëllimet e mësipërme, fjala "pakushtëzuar" do të thotë një garanci e zbatueshme me kërkesë dhe se nuk duhet të ketë ndonjë kusht ose kërkesë për ndonjë dëshmi të përfshirë në sigurimin e tenderit përveç një kërkese që Autoriteti Kontraktues duhet të ofroj një dokument që tregon që ka ndodhur shkelje në rregullat e tenderimit. Si rrjedhoje nuk ka nevojë të mëtejshme që autoriteti kontraktues të vërtetoj shkeljen.

3. Në mbështetje të neneve 57, paragrafi 5, dhe 63, paragrafi 5, të LPP, kërkesat për kualifikimin e lëshuesve të sigurimit të tenderit dhe ekzekutimit, siç është përcaktuar në dosjen e tenderit, do të jenë jo-diskriminuese, nuk do të kërkojnë nga lëshuesi që të ketë një biznes në një vend të veçantë, dhe në çdo rast do të kufizohet vetëm në

kriteret që janë të lidhura drejtpërdrejt me sigurimin e stabilitetit financiar dhe besueshmërinë e këtyre institucioneve.

Neni 14
Konfiskimi i sigurisë së ekzekutimit

1. Në zbatim të nenit 63 të LPP-së, siguria e ekzekutimit e depozituar nga tenderuesi fitues do të konfiskohet në rast të:

1.1 shkeljes së kontratës së nënshkruar, gjë e cila i shkakton dëme materiale autoritetit kontraktues dhe / ose detyron autoritetin kontraktues të bëjë shpenzime materiale për përfundimin e kontratës në fjalë;

1.2 shkeljes së kontratës së nënshkruar dhe mbesin pa paguar punëtorë, nënkontraktorë dhe / ose furnizues i mallrave.

2. Konfiskimi i sigurisë së ekzekutimit, nuk e ndalon autoritetin kontraktues të kërkojë zhdëmtimin shtesë që rrjedhin nga kontrata dhe, po ashtu, nëse siguria e ekzekutimit është me vlerë më të lartë se dëmet nga shkelja, autoriteti kontraktues duhet t'i rik-thejë diferencën.

Neni 15
Vlefshmëria e tenderit

1. Autoritetet kontraktuese duhet të cekin në dosjen e tenderit periudhën e vlefshmërisë së tenderit të kërkuar dhe të specifikuar si numër i ditëve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve. Periudha e vlefshmërisë së tenderit e kërkuar nuk duhet të jetë më e gjatë se sa është e nevojshme, si dhe duhet të jetë mjaft e gjatë në mënyrë që autoritetet kontraktuese t'i vlerësojnë tenderët e pranuar dhe të japin dhe nënshkruajnë kontratën.

2. Nën kushte të justifikueshme dhe/ose të jashtëzakonshme vonesa të papritura shfaqen, që do të thotë procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda periudhës së validitetit të tenderit për shkak të sqarimeve të detajeve teknikisht të komplikuara, AK do të kërkojë nga OE që të zgjasin afatin e validitetit të tenderëve të tyre. Është e hapur për secilin tenderues të vendosë nëse dëshiron të bëjë zgjatjen apo jo. Dështimi për të zgjatur afatin e validitetit të tenderit do të bëjë tenderin të "papërgjegjshëm".

3. Periudha e validitetit të tenderit do të përcaktohet prej jo më pak se 90 ditë kalendarike për kontrata të vlerës së madhe dhe të paktën 60 ditë kalendarike për kontrata të vlerës së mesme.

Neni 16

Krijimi i Komisioneve të Vlerësimit

1. Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, një autoritet kontraktues duhet të krijojë komisionin e vlerësimit (këtu e tutje të referuar si "komision").

2. Parimet në vijim do të krijojnë bazën për krijimin dhe funksionimin e Komisionit të tillë:

2.1. anëtarët e komisionit duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë siç janë specifikuar për anëtarët e stafit të Departamentit të Prokurimit në Nenin 23.3 të LPP-së, dhe do të nënshkruajnë deklaratën me shkrim.

2.2 anëtarët e komisionit i nënshtrohen dispozitave të Nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

2.3. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit nuk mund të shërbejnë si anëtarë i komisionit vlerësues. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit do të kryesojë komisionin e vlerësimit pa të drejtë vote. Ai/ajo do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e komisionit vlerësues dhe do të sigurojë respektimin e dispozitave të LPP-së.

2.4 Numri i anëtarëve të komisionit vlerësues do të varet nga vlera dhe kompleksiteti i aktivitetit të prokurimit, por në të gjitha rastet do të përbëhet nga jo më pak se (3) tre anëtarë dhe numri do të jetë gjithnjë tek. Komisioni do të përbëhet nga anëtarë me aftësi, njohuri dhe përvojë të nevojshme, relevante për kërkesat e prokurimit. Personat të cilët kanë qenë anëtarë të komisionit për hapje të ofertave, nuk mund te jenë anëtarë të komisionit vlerësues.

2.5. Autoriteti kontraktues qartë do të përcaktoj detyrat për Komisionin, të cilat në asnjë mënyrë nuk do të kufizojnë pavarësinë e Komisionit në procesin vendim-marrës.

2.6. Komisioni do të funksionoi nga dita e miratimit të vendimit për krijimin e komisionit deri në përmbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara nga autoritetit kontraktues, me shkrim, ose deri në vendimin për ndërprerjen e procedurës së prokurimit. Në rast që një apo më shumë anëtarë nuk janë në gjendje të marrin pjesë në komision, për arsye dhe rrethana objektive, ata do të zëvendësohen në të njëjtën mënyrë si në nominimin e tyre.

2.7. Komisioni do të marr vendimet e tij në takime me votë të thjeshtë të shumicës, me votim të hapur. Procesi i votimit do të regjistrohet në procesverbal.

2.8. Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të

specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

2.9. Komisioni, në fund të detyrës së tij, do të përgatit një rekomandim për Zyrtarin e Prokurimit së bashku me një raport mbi punën e komisionit dhe një deklaratë të arsyeve mbështetëse për rekomandimin.

2.10. Vendimi përfundimtarë për dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës për prokurim. Zyrtari i Prokurimit mund të pranoj rekomandimin e komisionit ose të refuzoj atë. Nëse rekomandimi i komisionit refuzohet, Zyrtari i Prokurimit duhet të shpjegoj arsyet me shkrim. Ne situata te tilla Zyrtari i Prokurimit mund te bjen vendimin përfundimtarë për dhënien e kontratës, ose mund të formojë Komision të ri për ri-vlerësim me procedurë te ngjajshme. Shpjegimi i tillë do të përfshihet në të dhënat e procedurës së aktivitetit të prokurimit. Zyrtari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues do të informohet menjëherë për refuzim të tillë.

2.11. Në rast se një anëtar i Komitetit të Vlerësimit të Ofertave konstaton se ai / ajo ka një konflikt interesi në vlerësimin e tenderit, ai / ajo duhet të deklarojë interesin e tij / saj në tender dhe të lëshoj takimin dhe nuk do të marrin pjesë më tej në procesin e vlerësimit. Individi, i cili nuk merr pjesë më në vlerësim, konsiderohet edhe më tutje si i betuar për konfidencialitet.

2.12. Nëse Zyrtari i Prokurimit është në dijeni se gjatë ushtrimit të aktivitetit të prokurimit ose dhënies së kontratës ka pasur një ose më shumë shkelje të LPP-ë, ai/ajo nuk do të nënshkruajë kontratën. Nëse Zyrtari i Prokurimin megjithatë e nënshkruan kontratën, atëherë Zyrtari i Prokurimit dhe të gjithë personat tjerë të cilët kanë marrë pjesë ose kanë inkurajuar shkeljen mbajnë përgjegjësi të plotë individuale për shkeljen. Për më tepër, çdo person i cili ushtron çfarëdo ndikimi në Zyrtarin e Prokurimit ose punonjësin e Departamentit të Prokurimit,ose që ndikon në ndonjë mënyrë tjetër në aktivitetin e prokurimit mban përgjegjësi të plotë individuale nëse ndikimi ka nxitur shkeljen e ligjit.

Neni 17
Ekzaminimi, vlerësimi, krahasimi i tenderëve dhe dhënia e kontratave

1. Autoritetet kontraktuese mund të përdorin vetëm kërkesa, kritere dhe specifikacione të publikuara ose parashtruara në dosjen e tenderit gjatë përzgjedhjes së tenderëve dhe dhënies së kontratës. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit.

2. Dispozita e përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë

vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së përfshirë një urdhër për ri-vlerësim në pajtim me Nenin 105, paragrafi 2.8, të LPP.

3. Në situata siç janë specifikuar në paragrafin 2 të këtij Neni, ri-vlerësimi mund të çoj në rezultat të ndryshëm vetë në aspektin e procesit të përzgjedhjes dhe dhënies, kur kushtet kanë ndryshuar. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

4. Procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve dhe dhënia e kontratave, siç është paraparë në Nenin 17, do të përfundohet nga autoriteti kontraktues brenda periudhës kohore më të shkurtër të mundshme dhe jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga hapja e tenderit, siç parashikon Neni 17 paragrafi 4 i kësaj rregulloreje. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara mirë, posaçërisht me kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet edhe për një afat shtesë prej 15 ditë kalendarke. Periudha e vlerësimit fillon menjëherë pasi të ketë përfunduar procedura e hapjes , por jo më vonë se 96 orë nga data e hapjes së tenderëve.

Neni 18
Ndërprerja dhe anulimi i procedurës së prokurimit

1. Kur një procedurë e prokurimit është iniciuar me publikim të njoftimit për kontratë ose njoftimit të konkursit të projektimit, ajo përmbyllet në ditën e publikimi të Njoftimit për Dhënien e Kontratës, ose Njoftimit të Rezultatit të Konkursit të Projektimit.

2. Pavarësisht nga Neni 62 i LPP-së, Procedura e prokurimit anulohet për një nga arsyet në vijim:

2.1 asnjë tender nuk është dorëzuar brenda afatit të specifikuar;
2.2 asnjë nga tenderët e pranuar nuk janë të përgjegjshëm;
2.3 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mënyrë të konsiderueshme tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues;
2.4 numri i tenderëve të përgjegjshëm të pranuar është më pak se (2);
2.5 asnjë kërkesë për pjesëmarrje në procedurën e kufizuar ose të negociuar pas publikimit nuk janë dorëzuar brenda afatit të specifikuar;
2.6 numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar ose të negociuar pas publikimit është më pak se dy (2);
2.7 asnjë projekt nuk është dorëzuar brenda afatit të specifikuar;
2.8 ose numri i projekteve të dorëzuara në konkursin e projektimit është më pak se dy (2);
2.9 asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm.

3. Për më shumë se ajo që është ofruar në paragrafin 2 të këtij Neni, procedura e dhënies anulohet për arsye të ngjarjeve të pa-parashikueshme dhe/ose arsyet jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk kanë mundur të parashikohen në kohën e inicimit të procedurës së prokurimit.

4. Pavarësisht nga dispozitat në paragrafët 2.4, 2.6, dhe 2.8 të këtij Neni, procesi i prokurimit mund të vazhdojë nëse rrethanat e ofruara në Nenin 32.5 të LPP janë të aplikueshme.

5. Në rast të anulimit bazuar në rrethana dhe arsye të deklaruara në këtë Seksion, autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj tenderuesve, pjesëmarrësve ose kandidatëve për anulim të një procedure të prokurimit, subjekt i dispozitave të Nenit 105, paragrafi 2.9 të LPP në lidhje me kompensimin e ankuesit.

6. Kur një procedurë e prokurimit anulohet për një nga arsyet e ofruara në këtë seksion, nëse autoriteti kontraktues ende dëshiron të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit në fjalë, mund të inicioni një procedurë të prokurimit pa ndryshuar numrin serik të prokurimit, por duke identifikuar atë me "Ri-tenderim" në Formuarin Standard "Njoftim për Kontratë". Fjala "Ri-tenderim" duhet të shënohet menjëherë pas titullit "Njoftim për Kontratë".

Neni 19
Kontratat Kornizë

1. Kontratat publike kornizë siç përkufizohen në Nenin 4, paragrafi 1.46, të LPP-se, janë marrëveshje që kanë për qëllim përcaktimin e kushteve që rregullojnë kontrata për tu dhënë gjatë një periudhe të caktuar. Sipas Nenit 38, Paragrafit 3, të LPP-se, kontrata të tilla do të kenë një kohëzgjatje deri në 36 muaj.

2. Një autoritet kontraktues mund të përdorë kontratat kornizë për të krijuar një kornizë për dorëzimin e furnizimeve, shërbimeve ose punëve gjatë një periudhe të caktuar me kusht që lëndët e nevojshme të përfshihen në kontratën kornizë.

Një numër i autoriteteve kontraktuese mund të bëjnë marrëveshje për të përdorur kontratat kornizë të përbashkëta me kusht që të gjithë autoritetet kontraktuese të paraqiten si autoritete kontraktuese në publikimin e njoftimit për kontratë që inicion procedurën.

Qeveria mund të vendos që të gjithë autoritetet kontraktuese të përkufizuara në Nenin 4, paragrafin 1.13, të LPP-se, duke përjashtuar Operatorët e Shërbimeve Publike për të cilët një aprovim nga bordi relevant mbikëqyrës është i nevojshëm, duhet që ti nënshtrohen kontratave kornizë dhe kështu nuk lejohen të bëjnë prokurimin e mallrave, shërbimeve ose punëve nga operatorë të tjerë ekonomik dhe

me kushte të tjera nga ato të dakorduara në kontratën kornizë. AQP, në pajtim me Nenin 95 të LPP-se, do të kryej dhe do të jetë përgjegjës për prokurimet sipas kontratës së tillë kornizë.

3. Për më shumë nga ajo që është ofruar në Nenin 38, Paragrafi 5, i LPP, kontratat e bazuara në marrëveshjen kornizë do të jepen në pajtim me procedurat e parashtruara në paragrafët 4 dhe 5 të këtij Neni. Ato procedura mund të aplikohen vetëm në mes të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik që ishin palë në fillim të marrëveshjes kornizë.

4. Kur lidhet një kontratë kornizë me një operatorë të vetëm ekonomik në pajtim me Nenin 38, Paragrafi 5.1 të LPP, kontrata duhet të lidhet në mënyrë që të përfshijë të gjitha kushtet përfshirë çmimet. Autoriteti kontraktues do të bëjë porosi me shkrim kurdo që ka nevojë zakonisht në lidhje me sasitë dhe afatin e dorëzimit; megjithatë kushte tjera përfshirë çmimet duhet të mbesin të pa-ndryshuara nga kontrata kornizë.

5. Kur një kontratë kornizë lidhet me një numër të operatorëve ekonomik në pajtim me nenin 38, paragrafi 5.2, të LPP, numri minimal i operatorëve ekonomik duhet të jetë jo më pak se tre.

Kontratat e bazuara në kornizë mund të epen ose:

5.1 duke aplikuar kushtet e parashtruara në kontratën kornizë pa ri-hapur konkurrencën, ose

5.2 kur jo të gjitha kushtet janë të parashtruara në kontratat kornizë, duke ri-hapur konkurrencën dhe, nëse është e nevojshme, kushte të formuluara në mënyrë më precize, përfshirë çmimet dhe sasitë, dhe kur është e nevojshme, kushte tjera të referuara në specifikacionet e kontratës kornizë.

Në rast të tilla, pa paragjykim të nenit 38, paragrafi 6 i LPP, kontratat do të epen në pajtim me procedurën në vijim:

(i) për çdo kontratë të shpërblyer, autoritetet kontraktuese do të konsultojnë me shkrim të gjithë operatorët ekonomik që janë pjesë e kontratës kornizë dhe të aftë për ekzekutimin e kontratës;
(ii) autoritetet kontraktuese do të përcaktojnë një afat kohorë të kufizuar prej jo më pak se pesë ditë që do të mjaftoj për të lejuar tenderuesve për secilën kontratë specifike që të bëjnë dorëzimi, duke konsideruar faktorët si kompleksitetin e lëndës së kontratës dhe kohën e nevojitur për të dorëzuar tenderët;
(iii) tenderët do të dorëzohen me shkrim, dhe përmbajtja e tyre do të mbetet konfidenciale;
(iv) autoritetet kontraktuese do të bëjnë dhënien e secilës kontratë për tenderuesin i cili ka dorëzuar tenderin më të mirë në bazë të kritereve të

dhënies të parashtruara në specifikacionet e kontratës kornizë për mini-tenderë.

6. Në pajtim me Nenin 38 të LPP, Autoritetet kontraktuese nuk mund të përdorin kontratat kornizë në mënyrë jo-adekuate ose në mënyrë që parandalon, kufizon ose shtrembëron konkurrencën.

7. Autoriteti kontraktues duhet të vendosë dhe të tregoj në dosjen e tenderit nëse kushtet e kontratës kornizë janë të përfshirë në tërësi dhe që rezultojnë me kontrata të mëtutjeshme ose thirrje pa ri-hapje të konkurrencës apo nëse ri-hapja e konkurrencës përmes mini-tenderit është paraparë.

Neni 20
Formularët e tenderëve dhe dorëzimi i tenderëve

1. Duke ju referuar LPP, autoritetet kontraktuese do të specifikojnë në dosjen e tenderit, siç është paraparë në Nenin 27 të LPP, formularin e tenderit që do të plotësohet dhe nënshkruhet nga tenderuesit. Formulari i tillë për tenderë përfshinë:

a. Identifikimin e operatorit ekonomik
b. Deklarata (t) e tenderuesit
d. Specifikacionet e çmimit të tenderit

2. Një tender përfshirë të gjitha anekset e tij do të dorëzohet te autoriteti kontraktues në formë origjinale dhe numri i kopjeve që autoriteti kontraktues ka përcaktuar qartë në dosjen e tenderit. Një nga kopjet e dorëzuara do të mbahet e pa-hapur nga autoriteti kontraktues si dëshmi në rast të dyshimeve mbi përmbajtjen e tenderit.

3. Tenderuesi do të mbyllë tenderin origjinal dhe secilën kopje në zarfe të ndarë dhe të shënoj zarfet qartë si "Origjinali" dhe "Kopje". Në pjesën e përparme të secilit nga zarfet e tilla do të shtohet saktësisht dhe asgjë më shumë se (i) Numri i Prokurimit siç është deklaruar në dosjen e tenderit dhe (ii) emri dhe adresa e tenderuesit. Zarfet pastaj do të mbyllen në një zarf të jashtëm të shënuar me Numrin e Prokurimit, Vërejtje që zarfi nuk do të hapet para datës dhe kohës së përcaktuar për hapjen e tenderëve dhe emri dhe adresa e tenderuesit.

Neni 21
Procedurat e hapura dhe të kufizuara

1. Autoritetet kontraktuese mund të zgjedhin që të përdorin procedurat e hapura dhe ato të kufizuara .

2. Gjatë dhënies së një kontrate përmes përdorimit të procedurës së hapur autoriteti kontraktues duhet të verifikoj që operatorët ekonomik janë të përshtatshëm dhe se ata përmbushin kriteret minimale të përzgjedhjes siç janë parashtruar në njoftimin

për kontratë dhe dosjen e tenderi. Vetëm pas verifikimit që operatori ekonomik është i përshtatshëm dhe përmbush kritere e cekura mund të vlerësohet tenderi dhe të krahasohet me tenderët tjerë. Tenderët që nuk janë të përshtatshëm ose nuk përmbushin kritere e selektimit nuk mund të konsiderohen gjatë dhënies së kontratës.

Neni 22
Sistemi me një dhe dy zarfe

1. Procedurat e tenderit në lidhje me procedurat e hapura për furnizime, shërbime dhe punë bëhen sipas sistemit me një zarf, që nënkupton që tenderët dorëzohen në zarfe të veçanta që përmban të gjitha informacionet në lidhje me tenderin përfshirë dokumentacionin për përshtatshmëri, dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kërkesave ekonomike dhe teknike dhe çdo informatë teknike në lidhje me ekzekutim të kontratës siç kërkohet në dosjen e tenderit. Për më shumë, zarfi i cekur përmban tenderin që do të thotë çmimet, përfshirë kur është e nevojshme nën-çmimet dhe kalkulimet.

2. Sistemi me dy zarfe mund të aplikohet, kur një procedurë e hapur ose e kufizuar përdorët, për shërbime konsulente, në veçanti shërbime intelektuale.

3. Në rastet e përmendura në paragrafin 2 të këtij Neni, autoritetet kontraktuese duhet të aranzhojnë tenderimin në mënyrë që kërkon nga operatorë ekonomik të dorëzojnë një përshkrim teknik përfshirë propozimin e tyre për metodat dhe detajet tjera teknike përfshirë përvojën, ekspertizën, mundësitë financiare dhe propozime të detajuara teknike në lidhje me projektin siç është përkufizuar në dokumentet e tenderit. Zarfi i dytë mund të përmbajë vetëm pjesën financiare të tenderit përfshirë çmimin ose çmimet në lidhje me tenderin e përshkruar.

4. Gjatë përdorimit të sistemit me dy zarfe autoritetet kontraktuese kërkojnë në dosjen e tenderit nga operatorët ekonomik të dorëzojnë tenderët e tyre në dy zarfe të mbyllura dhe brenda një zarfi të përbashkët.

5. Gjatë kohës së hapjes së tenderëve, vetëm zarfet që përmbajnë informatat teknike hapen dhe tenderët vihen në dispozicion për vlerësim teknik dhe radhitje të atyre që janë konstatuar si të kualifikuar për dhënie si Propozime Teknike të përgjegjshme. Zarfet që përmbajnë pjesën financiare të tenderit nuk mund të hapen deri në përfundim të vlerësimeve teknike dhe radhitjes së tenderëve dhe tenderuesit e radhitur të jenë njoftuar për kohën dhe vendin e hapjes duke i informuar ata për të drejtën e tyre për të qenë prezent në takim.

6. Në seancën e hapjes në lidhje me pjesën financiare të tenderëve autoriteti kontraktues lexon me zë pikët e shpërblyera për propozimet teknike dhe lexon me zë propozimin financiarë. Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj dhe krahasoj propozimet teknike dhe financiare në kombinim për të konstatuar tenderin e vlerësuar më lartë dhe për të bërë dhënien e kontratës.

Neni 23
Përzgjedhja e tenderëve për tu ftuar për dorëzim të tenderëve në procedurat e kufizuara ose procedurë të negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratës

1. Gjatë përdorimit të procedurës së kufizuar apo të negociuar, autoriteti kontraktues duhet të vlerësoj aplikacionet e pranuara me kohë në bazë të afateve të përcaktuara. Të gjithë dokumentet e kërkuara duhet të përfshihen kur një operator ekonomik aplikon për kualifikim.

2. Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë informata dhe dokumentacion shtesë, megjithatë dokumentacioni i kërkuar në njoftimin për kontratë mund të konsiderohet vetëm nëse dorëzohet brenda afatit kohorë të caktuar.

3. Gjatë kualifikimit të operatorëve ekonomik për tenderim në procedurë të kufizuar ose të negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë, autoritetet kontraktuese duhet të kualifikojnë të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë të përshtatshëm dhe përmbushin kriteret e përzgjedhjes; megjithatë nëse më shumë se gjashtë (6) operatorë ekonomik konsiderohen si të kualifikuar autoriteti kontraktues do të ftoj vetëm gjashtë nga operatorët ekonomik më të kualifikuar për të dorëzuar tenderët. Gjatë përzgjedhjes së operatorëve ekonomik më të kualifikuar autoriteti kontraktues duhet të jetë objektiv dhe të respektoj parimin e trajtimit të barabartë. Përzgjedhjen e operatorëve ekonomik për tenderim duhet bërë me referencë të kualifikimeve në lidhje me aspektet ekonomike, pajisjet relevante teknike dhe hapësirat si dhe përvojën në lidhje me implementimin praktik të kontratave të krahasueshme. Autoriteti kontraktues do të specifikoj faktorët që do të konsiderohen gjatë ri-ekzaminimit të aplikacioneve.

4. Operatorët ekonomik që janë kualifikuar gjatë fazës së kualifikimit siç është përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni mund të marrin pjesë në procedurën e tenderimit. Kështu autoriteti kontraktues do të dërgojë dosjen e tenderit vetëm te operatorët ekonomik të kualifikuar.

Neni 24
Gabimet Aritmetike

1. Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nga ana e autoritetit kontraktues në pajtim me Nenin 59 të LPP, kjo mund të bëhet vetëm në bazë të kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve të dhënies të parashtruara në procedurë, dhe përshtatshmëria dhe përgjegjshmëria mund të vendosën vetëm në bazë të informatave të dhëna në mënyrë të drejtë dhe objektive.

2. Nëse një gabim i natyrës krejtësisht aritmetike zbulohet gjatë vlerësimit, autoriteti kontraktues duhet të përmirësojë gabimet e tilla. Të gjithë tenderuesit duhet të informohen me shkrim në lidhje me këtë.

Neni 25
Tenderët jo normalisht të Ultë

1. Kur një autoritet kontraktues konsideron një tenderë të dorëzuar si jo normalisht të ultë në pajtim me Nenin 61, Paragrafi 1, i LPP-së, një vlerësim individual i tenderit në fjalë duhet të bëhet.

2. Autoriteti kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë abnormalisht i ultë, të bëjë një deklaratë e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe i cili përfshin një shpjegim për çmimin e ultë.

3. Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP-se autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profiti.

4. Nëse tenderi shihet si jo normalisht i ultë duhet të refuzohet dhe të mos konsiderohet kur bëhet dhënia e kontratës. KRPP duhet të njoftohet për refuzimin brenda dy ditëve në pajtim me Nenin 61, Paragrafi 5, i LPP-së.

5. Tenderuesi në fjalë duhet të informohet për rezultatin final të vlerësimit.

Neni 26
Sasitë në lidhje me kontratat për mallra, punë dhe shërbime

1. Autoritetet kontraktuese do të specifikojnë sasitë gjatë përgatitjes së materialeve tenderuese përfshirë publikimet, materialet tenderuese dhe kontratat.

2. Në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasitë mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikimi i përafërt i sasive duhet të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. Sasitë duhet të kenë për aq sa është e mundur afatet e dorëzimit.

3. Vlera totale e kontratave ose vlera e parashikuar te kontratës kornizë duhet të kalkulohet në bazë të çmimeve të artikujve duke shumëzuar me sasitë relevante ose sasitë e parashikuara të përafërta siç është përmendur në paragrafin 2.

Neni 27
Çmimet

1. Çmimet e deklaruara në tender dhe çmimet e mëtejshme në kontratat e dhëna janë çmime fikse dhe të obligueshme për palët e kontratës. Çmimet nuk mund të ndryshohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës; megjithatë kontratat afatgjate mund të përmbajnë mundësi të rregullimit të çmimit në pajtime me paragrafin 2 të këtij Neni.

2. Kontratat me kohëzgjatje prej më shumë se një viti mund të përshijnë klauzolë të veçantë në lidhje me rregullimin e çmimeve; megjithatë rregullime të tilla duhet të jenë të lidhura me indekse të një indeksi zyrtarë të çmimeve të përcaktuar nga autoritete në Kosovë ose nga institucionet tjera ndërkombëtare të autorizuara. Indeksi i çmimit duhet të specifikohet në dosjen e tenderit.

Neni 28
Nën-kontraktimet

1. Sipas Nenit 30 të LPP-se, operatorët ekonomike mund të nënkontraktojnë pjesë të kontratave të fituara; megjithatë nën-kontraktime të tilla nuk mund të tejkalojnë dyzet (40) përqind të vlerës totale të kontratës së fituar.

2. Operatori ekonomik që ka fituar kontratën mbanë përgjegjësinë e plotë për përmbushjen e kontratës në pajtim me kontratën pavarësisht që ndonjë pjesë nënkontraktohet të palët e treta.

3. Në dosjen e tenderit autoritetet kontraktuese do të ftojnë operatorët ekonomik që të tregojnë në tender çdo pjesë të kontratës që ata synojnë ta nënkontraktojnë te palët e treta. Këto të dhëna duhet të përmbajë identifikimin e nënkontraktuesve të propozuar përfshirë aktivitetin që parashihet të nënkontraktohet .

4. Tenderuesi duhet të dorëzoj dëshmi në lidhje me përmbushjen e përshtatshmërisë së nënkontraktuesit për pjesëmarrje në procedurën e tenderit siç kërkohet në Nenin 65 të LPP-se.

5. Operatori ekonomik duhet të njoftoj autoritetin kontraktues për çdo ndryshim në plane të nën-kontraktimit që ndodhin pas dorëzimit të tenderit. Autoriteti kontraktues mund të refuzoj çdo nënkontraktues të propozuar.

Neni 29
Aktivitetet e menaxhimit të kontratës

1. Autoriteti kontraktues konsideron në të gjithë tenderët nevojën për menaxhimin e kontratës dhe implementon procedurat e nevojshme dhe proceset për menaxhim të tillë. Kurdo që menaxhimi i kontratës kërkon ekspertizë të jashtme procedurat relevante të prokurimit duhet të iniciohen brenda një kohe që lejon inicimin e menaxhimit në kohën e implementimit të kontratës për dorëzim të furnizimeve, shërbimeve ose punëve.

Neni 30

Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit

1. Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit përfshinë trajnimin për "certifikate themelore profesionale të prokurimit" dhe trajnimin për "certifikate të avancuar profesionale të prokurimit". Trajnimi mund të vijohet nga:

1.1 persona të cilët janë zyrtarë të prokurimit, anëtarë të stafit të njësive të Prokurimit dhe shërbyes civil;
1.2 personat që mbajnë një certifikatë të nivelit master të njohur ndërkombëtarisht ose diplomë në prokurim; dhe
1.3 çdo person tjetër.

2. IKAP në bashkëpunim me KRPP-në, vendosin sa persona nën nën-paragrafin 1.3 mund të akomodohen në trajnim, pasi paraprakisht IKAP të ketë aprovuar një rregullore në të cilën detalizohen kushtet për vijimin e trajnimit. Njoftimi duhet të publikohet në faqen e internetit të IKAP-it dhe KRPP-së.

3. Personat e përmendur në nën-paragrafin 1.3 të këtij Neni që dëshirojnë të vijojnë trajnimin aplikojnë me shkrim në IKAP. Qasje do të kenë një numër i personave i caktuar, dhe nëse numri i aplikantëve është më i lartë se numri i vendeve të alokuar nga IKAP, aplikantët do të përzgjidhen në bazë të radhitjes së datave të aplikimit.

4. IKAP vendosë tarifën që duhet të paguhet nga secili person i përmendur në nën-paragrafin 1.3 për pjesëmarrje në trajnim. Tarifa duhet të përcaktohet në bazë të kalkulimit të kostos për trajnim përfshirë akomodimin dhe pagën e trajnerit përpjesëtuar me numrin e pjesëmarrësve që mund të vijojnë. IKAP mund të vendos një shumë shtesë prej 30 % nga ajo e kalkuluar mësipërm për të mbuluar kostot fikse.

5. Pagesat për materialet e trajnimit për personat e përmendur te nën-paragrafi 1.3 mund të përcaktohen gjithashtu për të mbuluar shpenzimet e prodhimit të materialeve për pjesëmarrësit.

6. Personat e cekur te nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 nuk mund të obligohen me tarifën e cekur në paragrafin 4 të këtij Neni ose për materialet e trajnimit. Selektimi i këtyre personave bëhet nga IKAP në bashkëpunim me KRPP-në.

7. Personat të cilët posedojnë një certifikatë ose diplomë të avancuar ose master të prokurimit të njohur ndërkombëtarisht janë të përjashtuar nga obligimi për certifikim nga IKAP siç është përcaktuar në paragrafët 4 dhe 5 të Nenit 25 të LPP-së.Megjithatë, këta persona janë të obliguar që të marrin pjesë në trajnimin e vazhdueshëm të për-caktuar në paragrafin 1 të Nenit 25 te LPP-së. Certifikatë ose diplomë e avansuar kon-siderohen, një certificatë ose diplomë e avansuar, të cilën e disponon një kandidat, dhe e cila është fituar në një institucion të licencuar arsimor, brenda apo jashtë Kos-

ovës, nëse programi arësimor është i bazuar në Direktivat e Prokurimit të KE, si dhe në praktikat më të mira ndërkombtare, të ketë zgajtur minimum 15 ditë, si dhe në fund kandidati të i është nënshtruar provimit dhe me sukses ta ketë perfunduar atë. Diplomë master e prokurimit publik konsiderohet ajo diplomë e cila është fituar në një institucion të licencuar arsimor brenda apo jashtë Kosovës, dhe që i përketë drejtimit të prokurimit publik.

8. IKAP në bashkëpunim me KRPP vendosin:

(i) përmbajtjen e trajnimit themelor të prokurimit dhe gjithashtu vendos numrin e ditëve të trajnimit. Numri i cekur i ditëve nuk mund të jetë më pak se 15 ditë brenda tri viteve;

(ii) përmbajtjen e trajnimit të avancuar të prokurimit dhe gjithashtu vendos numrin e ditëve për trajnim. Numri i cekur i ditëve nuk mund të jetë më pak se 15 ditë brenda tri viteve.

9. Certifikatat Profesionale të Prokurimit, siç janë referuar në Paragrafin 1 të këtij Neni, mund të revokohen nga OSHP në pajtime me Nenet 25, Paragrafi 8, i LPP-se.

10. Sipas dispozitave të Nenit 25, Paragrafi 8 i LPP-se, OSHP mund të vazhdoj me revokim të Certifikatës Profesionale të Prokurimit me kërkesë të KRPP, ku KRPP, sipas Nenit 87, Paragrafi 2.4 i LPP-se, ka dëshmi që kushtet e kërkuara nën Nenet 32, Paragrafi 4, dhe Neni 35 të LPP-se janë shkelur.

Neni 31
Operatorët e Shërbimeve Publike

1. Gjatë dhënies së kontratave publike, Operatorët e Shërbimeve Publike, siç janë dalluar në Nenin 4, paragrafi 1.50, të LPP, i nënshtrohen dispozitave të referuara në paragrafët në vijim dhe atyre të ofruara në Kapitullin V të LPP.

2. Sipas paragrafit 1 të këtij Neni, Operatorët e Shërbimeve Publike janë:

2.1 Autoritetet Kontraktuese të cilat kryejnë Aktivitete të Shërbimeve Publike siç është referuar në Nenin 4, paragrafin 1.49, të LPP;

2.2 Ndërmarrjet publike, siç janë dalluar në Nenin 4, Paragrafi 1.51, të LPP, të cilat kryejnë Aktivitetet të Shërbimeve Publike siç referohet në nenin 4, paragrafi 1.49, të LPP;

2.3. kompanitë private dhe të gjitha entitetet tjera të referuara në Nenin 4, paragrafi 1.13, të LPP, të cilat kryejnë Aktivitete të Shërbimeve Publike siç është referuar në Nenin 4, paragrafi 1.49, të LPP dhe funksionojnë në bazë të

të Drejtave te Veçanta ose Ekskluzive siç janë definuar në Nenin 4, Paragrafi 1.58, të LPP.

3. Për arsye të natyrës së veçantë të operatorëve të shërbimeve publike dhe obligimeve të tyre për të shërbyer publikut në baza të pa-ndërprera një fleksibilitet relativ është mundësuar.

4. Fleksibiliteti i cekur përbëhet nga mundësia që operatorët e shërbimeve publike të kenë dy procedura të prokurimit shtesë në lidhje me përzgjedhjen ose parakualifikimin e operatorëve ekonomik. Procedurat e përmendur janë ftesa për tenderim përmes njoftimeve paraprake dhe sistemit të kualifikimit.

5. Ftesa për tenderim përmes njoftimeve paraprake eliminon publikimin e njoftimit për kontratë, me kusht që njoftimi paraprak:

i. qartë i referohet furnizimit, shërbimit ose punëve të parashikuara;
ii. njofton se tenderuesit do të ftohen pa publikime të mëtutjeshme; dhe
iii. njofton se operatorët ekonomik duhet të shprehin interesimin e tyre me shkrim kur njoftimi paraprak të publikohet.

6. Operatorët e shërbimeve publike mund të publikojnë njoftimet e tyre indikative në çdo kohë të vitit; Publikimet e tilla nuk do të zëvendësojnë njoftimin vjetorë paraprak të cekur në Nenin 39 të LPP-se, por duhet të mbulojnë prokurimet e nevojshme të cilat nuk kanë qenë të parashikueshme kur publikimi vjetorë është përgatitur në fillim të vitit.

7. Operatorët e shërbimeve publike që dëshirojnë të përdorin sistemin e kualifikimit do të publikojnë këtë në faqe të internetit të KRPP-se duke ftuar operatorët ekonomik të aplikojnë për përfshirje në listën e furnizuesve që përmbushin kriteret. Një sistem i kualifikimit mund të zgjatë vetëm për tri vite, pastaj një publikim i ri duhet të dorëzohet. Të gjithë operatorët duhet të aplikojnë pastaj. Kjo përfshinë edhe ata të pranuar në sistemin paraprak të kualifikimit.

8. Ofruesi i shërbimeve publike që përdorë sistemin e kualifikimit duhet të përtërijë sistemin e tyre çdo gjashtë muaj përfshirë të gjitha ndryshimet në kritere dhe kërkesat korresponduese të dokumentacionit dhe metodën për verifikim të kritereve. Përtëritja duhet të bëhet në kopje të letrës dhe në mënyra elektronike përfshirë publikimin në faqen e internetit të KRPP-së.

9. Operatorë e shërbimeve publike që dëshirojnë të përdorin procedurat e cekura në paragrafin 4 të këtij Neni duhet të kërkojnë nga operatorët ekonomik të cilët kanë shprehur interesim pas publikimit të njoftimit paraprak dhe të cilët janë kualifikuar në sistemin e kualifikimit që të konfirmojnë interesimin e tyre. Kjo duhet të bëhet me shkrim.

10. Operatorët e shërbimeve publike dërgojnë dosjet e tenderëve duke ftuar ofertimet nga ata operatorë ekonomik që kanë konfirmuar interesimin.

Neni 32
Përdorimi i mënyrave elektronike përfshirë e-prokurimet, e-ankandet dhe sistemin dinamik të blerjes

1. Qeveria mund të nxjerrë rregulla në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik, siç janë e-prokurimet, e-ankandet dhe sistemi dinamik i blerjes.

2. Përdorimi i metodave të tilla duhet të bëhet në pajtim me kushtet e parashtruara në Aneksin 1 të këtyre rregullave.

Aneksi 1 (e-prokurimi)

Në pajtim me dispozitat e Nenit 32 të këtyre Rregullave, duhet të bëhet implementimi si në vijim.

1. Kërkesat në lidhje me pajisjet për pranimin e tenderëve elektronik, kërkesave për pjesëmarrje.

1. Autoritetet kontraktuese mund të përdorin metoda elektronike të komunikimit, siç janë të përkufizuara në Nenin 4, paragrafi 1.21, të LPP, dhe të bazohen në teknika të prokurimit elektronik duke përdorur metoda elektronike të komunikimit me kusht që përdorimi i tillë është në përputhje me Nenin 129 të LPP-se dhe në asnjë mënyrë nuk bien ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, jo-diskriminimin dhe transparencën.

2. Autoritetet kontraktuese mund të sigurojnë që të gjitha komunikimet, përveç vizitave në vendin e punës dhe takimet para-tenderuese në pajtim me Nenin 55 të LPP, ose disa nga komunikimet dhe shkëmbimet e informatave me operatorët ekonomik, mund të kryhen përmes metodave elektronike në pajtim me paragrafët 3 dhe 4 të këtij Neni.

Në raste të tilla metodat elektronike të komunikimit të zgjedhura nga autoriteti kontraktues duhet të jenë përgjithësisht në dispozicion dhe ndërfunksionuese me pajisjet e informatave dhe komunikimit në përdorim të zakonshëm nga të tjerët, dhe në këtë mënyrë të mos kufizojnë qasjen e operatorëve ekonomik në procedurën e tenderimit.

3. Komunikimi dhe shkëmbim dhe ruajtja e informatave me metoda elektronike do të kryhet në mënyrë të tillë që të sigurohet integriteti i të dhënave dhe Konfidencialiteti i tenderëve dhe kërkesave për pjesëmarrje të ruhen, dhe që autoritetet kontraktuese të ekzaminojnë përmbajtjen e tenderëve dhe kërkesave për pjesëmarrje vetëm pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar për dorëzimin e tenderëve.

4. Pajisjet për pranimin elektronik të tenderëve, kërkesave për pjesëmarrje dhe planet dhe projektet në konkurse duhet të paktën të garantojnë, përmes aspekteve teknike dhe procedurave të duhura që:

4.1 nënshkrimet elektronike të lidhura me tenderë, kërkesa për pjesëmarrje dhe plane dhe projekte të respektojnë dispozitat kombëtare të miratuara sipas Direktivës 1999/93/EC;
4.2 koha dhe data e saktë për pranimin e tenderëve, kërkesave për pjesëmarrje dhe dorëzimeve të planeve dhe projekteve mund të përcaktohet saktësisht;
4.3 të sigurohet në mënyrë të arsyeshme që para përcaktimit të afatit kohorë, askush nuk mund të ketë qasje në të dhënat e transmetuara nën këto kërkesa;
4.4 nëse kufizimi në qasje shkelet, duhet të sigurohen mënyra për të detektuar qartë një shkelje të tillë;
4.5 vetëm personat e autorizuar mund të caktojnë ose ndryshojnë datat për hapjen e të dhënave të pranuara;
4.6 gjatë fazave të ndryshme të procedurës së dhënies së kontratës ose të konkursit, qasje në të gjitha të dhënat e dorëzuara, ose një pjesë të tyre, duhet të jenë të mundshme vetëm përmes veprimeve simultane nga persona të autorizuar;
4.7 veprimet simultane nga persona të autorizuar duhet të mundësojnë qasje në të dhëna të transmetuara vetëm pas datës së përcaktuar;
4.8 të dhënat e pranuara dhe të hapura në pajtim me këto kërkesa duhet të mbesin në dispozicion vetëm për personat e autorizuar për referencë.

2. Sistemi Dinamik i Blerjes

1. Në mënyrë që të përcaktohet sistemi dinamik i blerjes, siç është përkufizuar në nenin 4, nën-paragrafin 1.18 të LPP-se, autoritetet kontraktuese do të ndjekin rregullat e procedurës së hapur në të gjitha fazat deri në dhënien e kontratës për tu përmbyllur nën këtë sistem. Të gjithë tenderuesit që përmbushin kriteret e përzgjedhjes dhe që kanë dorëzuar një tender indikativ që respekton specifikacionet dhe dokumente tjera shtesë mund të dorëzohen në sistem; tenderët indikativ mund të përmirësohen në çdo kohë me kusht që të vazhdojnë të respektojnë specifikacionet. Me qëllim të vendosjes së sistemit dhe të dhënies së kontratës nën këtë sistem, autoritetet kontraktuese do të përdorin vetëm metodat elektronike sipas Nenit 32 të këtyre Rregullave.

2. Për qëllim të vendosjes së sistemit dinamik të blerjes, autoritetet kontraktuese do të:

2.1 publikojnë njoftimin për kontratë duke bërë të qartë që sistemi dinamik i blerjes është i involvuar;

2.2 të tregohet në specifikacione, në mesin e çështjeve tjera, natyra e blerjes së parashikuar nën këtë sistem, si dhe të gjitha informacionet në lidhje me sistemin e blerjes, pajisjet elektronike të përdorura dhe aranzhimet e lidhjeve dhe specifikacioneve teknike;
2.3 të ofrohet përmes metodave elektronike, nga publikimi i njoftimit dhe deri në skadim të sistemit, qasje të pakufizuar, direkte dhe të plotë në specifikacione dhe çdo dokumentacion shtesë dhe do të tregojë në njoftim adresën e internetit në të cilën dokumentet e tilla mund të konsultohen.

3. Autoritetet kontraktuese do ti japin çdo operatori ekonomik, gjatë tërë periudhës së sistemit dinamik të blerjes, mundësinë për dorëzimin e tenderit indikativ dhe për pranimin në sistem nën kushtet e referuara në paragrafin 2 të këtij Neni.

Ata duhet të përfundojnë vlerësimin brenda jo më shumë se 15 ditë nga data e dorëzimit të tenderit indikativ. Megjithatë, ata mund të zgjasin periudhën e vlerësimit me kusht që asnjë njoftim për tenderim nuk lëshohet në ndërkohë.

Autoriteti kontraktues do të informojë tenderuesin e cekur në nën-paragrafin e parë në mundësinë e parë të mundshme të pranimit në sistemin dinamik të blerjes ose të refuzimit të tenderit indikativ.

4. Secila kontratë specifike duhet të jetë lëndë e një ftese për tender. Para lëshimit të ftesës për tender, autoritetet kontraktuese do të publikojnë një njoftim për kontratë të thjeshtëzuar duke ftuar të gjithë operatorët ekonomik të interesuar për të dorëzuar një tender indikativ, në pajtim me paragrafin 3, brenda afatit kohor që mund të jetë jo më pak se 15 ditë nga data në të cilën njoftimi i thjeshtëzuar ishte dërguar. Autoritetet kontraktuese nuk mund të vazhdojnë me tenderim deri në përfundim të vlerësimit të të gjithë tenderëve indikativ të pranuar në atë afat kohor.

5. Autoritetet kontraktuese do të ftojnë të gjithë tenderuesit e pranuar në sistem për të dorëzuar një tender për secilën kontratë specifike për dhënie nën këtë sistem. Për këtë arsye ata do të përcaktojnë një afat kohorë për dorëzimin e tenderëve.

Ata do të bëjnë dhënien e kontratës për tenderuesin i cili ka dorëzuar tenderin më të mirë në bazë të kritereve të dhënies të përcaktuara në njoftimin për kontratë për vendosjen e sistemit dinamik të blerjes. Ato kritere mund të formulohen, sipas rrethanave, në mënyrë më precize në ftesën e cekur më lartë.

6. Një sistem dinamik i blerjes nuk mund të zgjatë më shumë se katër vite, përveç në raste të veçanta të justifikueshme.

Autoritetet kontraktuese nuk mund të përdorin këtë sistem për të parandaluar, kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën.

Asnjë tarifë nuk mund të faturohet për operatorët ekonomik ose palëve të sistemit.

3. Përdorimi i ankandeve elektronike

1. Në pajtim me Nenin 4, Paragrafi 1.20 të LPP, autoritetet kontraktuese në procedura të hapura dhe kufizuara mund të vendosin që dhënia e kontratës publike do të paraprihet nga një ankand elektronik, kur specifikimet e kontratës mund të përcaktohen me precizitet dhe nuk kërkon vlerësim diskret .

Në rrethana të njëjta, një ankand elektronik mund të mbahet me rihapjen e konkurrencës në mes të palëve të marrëveshjes kornizë dhe me hapjen për konkurrencë për kontratat që do të shpërblehen nën sistemin dinamik të blerjes të referuara në Nenin 2 të këtij Aneksi.

Ankandi elektronik do të bazohet:

i. ose vetëm në çmime kur shpërblimi i kontratës është çmimi më i ulët; ose
ii. në çmime dhe/ose në vlera të reja të veçorive të tenderëve të treguara në specifikacione kur shpërblimi i kontratës është për tenderin ekonomikisht më të favorshëm.

2. Autoritetet kontraktuese të cilat vendosin të mbajnë një ankand elektronik do të deklarojnë atë fakt në njoftimin për kontratë.

Specifikacionet do të përfshijnë, në mesin e çështjeve tjera, detajet në vijim:

2.1 veçoritë, vlerat e të cilave do të jenë lëndë e ankandit elektronik, me kusht që veçoritë e tilla të jenë të kuantifikueshme dhe që mund të shprehen në shifra ose përqindje;
2.2 çdo kufizim i vlerave të cilat mund të dorëzohen, siç rezultojnë nga specifikacionet lidhur me lëndën e kontratës;
2.3 informatat të cilat do të vihen në dispozicion për tenderuesit gjatë ankandit elektronik dhe, sipas rrethanave, kur do të vihet në dispozicion për ata;
2.4 informatat relevante në lidhje me procesin e ankandit elektronik;
2.5 kushtet nën të cilat tenderuesit do të jenë në gjendje të ofertojnë dhe, në veçanti, dallimet minimale të cilat, sipas rrethanave, do të kërkohen gjatë ofertimit.
2.6 informacionet relevante në lidhje me pajisjet elektronike të përdorura dhe aranzhimet dhe specifikimet teknike për lidhje.

3. Para fillimit të ankandit elektronik, autoritetet kontraktuese do të bëjnë vlerësimin e plotë të tenderëve në pajtim me kriteriumin/kriteret e dhënies të përcaktuara dhe me peshët e caktuara për ato.

Të gjithë tenderuesit të cilët kanë dorëzuar tenderë të pranueshëm do të ftohen njëkohësisht me metoda elektronike për të dorëzuar çmime të reja dhe/ose vlera të

reja; ftesa do të përmbajë të gjitha informatat relevante në aspektin e kyçjes individuale në pajisjet që përdorën dhe do të tregojë datën dhe kohën e fillimit të ankandit elektronik.

Ankandi elektronik mund të mbahet në disa faza të njëpasnjëshme. Ankandi elektronik mund të mos filloj deri para dy ditëve të punës pas datës në të cilën ftesat janë dërguar.

4. Gjatë dhënies së kontratës në bazë të tenderit ekonomikisht më të favorshëm, ftesa do të përcjellët me një rezultat të vlerësimit të plotë të tenderit përkatës, të kryer në pajtim me peshët e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Ftesa do të deklaroj formulën matematikore që do të përdorët në ankandin elektronik për të përcaktuar ri-radhitjet automatike në bazë të çmimeve të reja dhe/ose vlerave të reja të dorëzuara. Formula do të përmbajë edhe peshët e të gjitha kritereve të përcaktuara për të vlerësuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, siç është treguar në njoftimin për kontratë ose në specifikacione; për këtë qëllim, çdo seri, megjithatë, duhet të reduktohet paraprakisht në një vlerë të specifikuar.

Kur variantet janë të autorizuara, një formulë e veçantë do të ofrohet për secilin variant.

5. Gjatë secilës fazë të ankandit elektronik autoritetet kontraktuese do të komunikojnë njëkohësisht me të gjithë tenderuesit të paktën informatat e mjaftueshme për të mundësuar ata që të kenë parasysh radhitjet relative në çdo moment. Ata gjithashtu mund të komunikojnë informata tjera në lidhje me çmimet ose vlerat e dorëzuara, me kusht që kjo të është deklaruar në specifikacione.

Ata gjithashtu mund që në çdo kohë të shpallin numrin e pjesëmarrësve në atë fazë të ankandit. Në asnjë rast, megjithatë, ata nuk munden që të zbulojnë identitetet e tenderuesve gjatë ndonjë faze të ankandit elektronik.

6. Autoritetet kontraktuese do të përmbyllin ankandin elektronik në një ose më shumë nga mënyrat në vijim:

6.1 në ftesë për pjesëmarrje në ankand ata do të tregojnë datën dhe kohën e fiksuar paraprakisht;
6.2 kur ata nuk pranojnë çmime tjera të reja ose vlera të reja të cilat përmbushin kërkesat në lidhje me dallimet minimale. Në atë rast, autoritetet kontraktuese do të deklarojnë në ftesë për pjesëmarrje në ankand kohën të cilën do ta lejojnë të kalojë pas pranimit të dorëzimit të fundit para përmbylljes së ankandit elektronik;
6.3 kur numri i fazave të ankandit, të fiksuara në ftesë për pjesëmarrje në ankand, është përfunduar.

7. Pas përmbylljes së ankandit elektronik autoritetet kontraktuese do të bëjnë dhënien e kontratës në bazë të rezultateve të ankandit publik.

8. Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndërhyjnë në ankandet elektronike dhe nuk mund të përdorin ato në atë mënyrë që parandalon, kufizon ose shtrembëron konkurrencën ose të ndryshojë lëndën e kontratës, siç është përcaktuar për tender në njoftimin e kontratës të publikuar dhe të përkufizuara në specifikacione.

Pjesë e Rregullores për Prokurim Publik konsiderohet edhe **UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK**, si legjislacion dytësor, i cili është i publikuar në vazhdim të kësaj Rregulloreje.

Hyrja në fuqi: 01.02.2012

Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-së